

## KRITIKA E RECENSIONE

**Dr. Ismet Dërmaku: RILINDJA KOMBËTARE SHQIPTARE DHE KOLONITË SHQIPTARE TË MËRGIMIT NË RUMANI DHE BULLGARI,**  
Prishinë, 1983,

Studimi monografik i Dr. Ismet Dërmakut: *Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe Kolonitë Shqiptare të mërgimit në Rumani dhe Bullgari* i përket fondit të veprave të rralla historiografike për mendimin politik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. E paraqesim në këtë vend për shkak të rëndësisë së dyfishtë që ka vepra e cila tash në shitje mungon. Rëndësia e përgjithshme e saj qëndron në faktin se trajton problematikë më pak të njohur për mjedisin tonë lexues dhe për kulturë të përgjithshme. Vepra është e shkruar në gjuhë të kuptueshme e të kapshme lehtë, me problematikë të shtruar në shtrirjen kronologjike, e shoqëruar me ilustrime, sikur përçjellë jetën e dy familjeve në stilin e rrëfimit romanesk historik. Është mobilizuese dhe lexohet me një frymë, kështu që lexuesi nga kjo prozë historike më lehtë se kudo gjetkë mëson për bazat e përgjithshme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Leximi i saj paraqet edhe zbavitje kulturore të gjitha këto kësaj veprë i dhënë edhe karakter popullor.

Ndërkaq, rëndësia e veçantë e këtij studimi qëndron në të dhënat që përmban si hulumtim e informim shkencor. Vepra është ngritur mbi një bazë të fortë të burimeve kryesore të Rilindjes, mbi të dhëna të reja arkivore dhe mbi të dhëna historiografike të vjela e të sistematizuara mirë. Studimin që kemi në duar e përshkon lehtë fryma e romantizmit rilindës të imponuar nga përmbajtja rilindëse romantike të burimeve, gjë që veprën e ofron shumë më afër lexuesit dhe hulumtuesit.

Realisht, në shkencë dhe veçanërisht në historiografi asgjë nuk lind krejt e re. Por, çdo e vjetër e njohur për një rreth gjurmuesish e plotësuar me të dhëna të reja, ose vetëm e shtruar sipas një përfaqëje të re, paraqet risi dhe pasurim në fondin e dijes dhe të kulturës. Së këndejmi, në të dhënat dhe në informatat që ofron vepra në fjalë ne hetojmë edhe freskinë e sjellë në historiografinë shqiptare, e edhe të mirën materiale kulturore që autori ia lëshoi në duar akcilit gjurmues të ardhshëm.

Sistematizimi i të dhënave të njohura dhe i të atyreve rishtazi të zbuluara për formimin e kolonive në Bullgari dhe Rumani paraqesin njohuri kritike mbi këto probleme shkencore. Mërgimet e para në këto vende kishin karakter social-ekonomik dhe ato nisen fill në shek. XIV në Bullgari, kurse në Rumani diçka më vonë, kryesisht si pasojë e pushtimit osman. Shqiptarët e mërguar në Bullgari formuan fshatra dhe lagje të qyteteve, kurse ata në Rumani kuarte të lokaliteve të mëdha. Mërgata shqiptare, veçmas ajo në Rumani, Rilindjes rumune i dha dijetarë, ideologë e udhëheqës të Revolucionit Demokratik-Borgjez. Madje, tri familjet shqiptare: *Lupi*, *Duka* e *Gjika* i dhanë frymë të tërë jetës politike rumune në shekujt XVII-XIX. Në gjiun e kësaj mërgate u burrërua vepruesi kushtrimdhënës i Rilindjes Shqiptare, Naum *Veqilharxhi* (i lindur më 1797). Ndërkaq, nga familja Gjika doli dijetarëja më zëdhënëse për Çështjen shqiptare në vitet '60-80 të shek. XIX, *Elenë Gjika* (1829-1888). Këto dy personalitete, sipas I. Dërmakut i dhanë vulën rilindëse platformës

së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Veçanërisht trajtim: i N. Veqilharxhit, në shumëçka, paraqet plotësim të zbrastësive historiografike, e posaçërisht për kohën e shpërnguljes së tij në Rumani, për veprimtarinë e tij dhe për kohën dhe mënyrën e vdekjes së Veqilharxhit, me gjasë më 1846.

Ismet Dërmaku, në udhë e sipër, solli edhe informata sintetike për formimin dhe aktivitetin kombëtar, kulturor e arsimor të kolonive në Itali, Turqi, Rusi, Greqi, madje edhe për veprimtarinë politike e kulturore në viset shqiptare në atdhe. Këtë e bëri në një masë bukur të matur, sa për ta vërë në spikamë lidhjen e pashkëputshmërinë e jetës dhe të veprimtarisë së kolonive shqiptare në Bullgari e në Rumani me kolonitë dhe me atdheun. Duke folur për *Krizën Lindore* vuri në spikamë rrethanat e vështira në të cilat u nis dhe u rrit Lëvizja e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Organizatë të parë politike të Rilindjes shqiptare I. Dërmaku e quan *Shoqërinë e të Shtypurit Shkronja Shqip* (1879) të Stambollit. Realisht, fillin e aktivitetit të kësaj organizate (shoqërie) e gjejmë shumë më heret dhe pikërisht në fillim të viteve '50 të shek. XIX. Rëndësia e kësaj shoqërie qëndron në faktin se ajo i parapriu veprimtarisë rilindëse shqiptare të kolonive në emigrim, në Rumani dhe në Bullgari. Veprimtaria kombëtare në këto koloni, sipas rezultateve që siguroi I. Dërmaku, është zhvilluar gjatë tërë kohës në lidhje të ngushtë midis tyre dhe atdheut.

Në Bullgari, sipas I. Dërmakut, filli i organizimit të Lëvizjes shqiptare të Mërgatës për çlirimin e Shqipërisë daton nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) dhe nisi me publicistin në gjuhën turke e bullgare *Jusuf be — Albania* (i lindur në Perenik të Kërçovës). Ndërkaq, organizimi politik shqiptar në frymën e Rilindjes i mërgatës në Rumani ka filluar pas shpërndarjes me dhunë të *Shoqërisë e të Shtypurit Shkronja Shqip* (1884). Këso kohe në Bukuresht u formua Shoqëria *Drita*, e cila mori mbi vete punët dhe de-

tyrat që ia parashtronte Komiteti i Stambollit, si komitet qëndror ilegal. Në vitin 1887 Shoqëria *Drita* u nda në dysh. Prej saj doli Shoqëria *Ditura*. Këto dy shoqëri njëra ndaj tjetrës patën qëndrime separatiste. Ato formuan degë të veta në kolonitë e tjera shqiptare në Rumani, kurse dega e *Dritës* në Brailë e para e nxori gazetën *Lumnia* (*Drita*) më 1887 në gjuhën rumune. Ndërkaq, gazetën e parë edhe në shqipe e nxori *Drita* e Bukureshtit dhe pikërisht gazetën *Shqiptari* (Albanezul), më 1888. Shoqëritë *Drita* e *Ditura* zhvilluan veprimtari të madhe në përhapjen e librit shqip në vendet me shqiptarë. Ato i mbajtën shkollat e para rilindëse në Korçë e rrethinë, me libra, mjeteq e të holla.

I. Dërmaku, këtu e ndjeku këmbakëmbës veprimtarinë politike, kulturore e arsimore të shumë veprimtarëve të Rilindjes shqiptare. Me një dozë simpatie e ndriçoi rilindësin Nikollë Naço, personalitet ky që kërkon dhe meriton përqsasje të veçantë. Autori solli informata të mira për veprimtarinë e *Shkollës Normale të Naços* në Bukuresht (1892) dhe mori përfundime se ajo ishte një si fakultet ku u përgatiten kuadrot e para për Publicistikën Shqiptare të Rilindjes. Në Rumani dolën shumë gazeta e revista të cilat mund të shfrytëzohen për burime të Rilindjes, si *Albanezul-Shqipetari* (1895), *Shqipëria* (1897), *Yll'i Shqipërisë* (1898), *La Renaissance Albanais* (Perlindja Shqiptarë) (1903), *Viata Albano-românâ* (Jeta Shqiptaro-Rumune) (1909), *Zëri i Shqipërisë* (1910), rumunisht, etj. Në këtë shtyp u trajtuan gjerësisht Lëvizja për pavarësi: aktiviteti i Lidhjes *Besa besë* të Pejës (1899), Lëvizja për shkollë, për gjuhë e për kishë shqipe. Veprimtari me të gjithanshme zhvilloi Shoqëria *Djalëria Shqiptare* e Brailës (1904), e cila, në fakt, ishte shoqëri e inteligjencies shqiptare të kohës, bartëse e aktiviteteve kryesore publicistike, kulturore, shkencore, letrare e arsimore shqiptare në prag të pavarësisë së Shqipërisë.

Nga fundi i shek. XIX, gati si filialë e aktivitetit kombëtar shqiptar të mërgatës në Rumani, nisi filli i punës kulturore e publicistike i

kolonisë shqiptare të Bullgarisë. Bartëse e këtij aktiviteti u bë Shoqëria *Dëshira e Sofjes* (1893), e cila sa vinte thellonte e zgjeronte veprimtarinë politike, kulturore e organizative të pavarur. Në vitin 1896 në Sofje u ngrit Shtypshkronja *Mbrothësia*, në të cilën u shtypen shumë organe e vepra të Rilindjes shqiptare. Punëtori më i dalluar në veprimtarinë botuese tipografike në Sofje ishte *Kristo Luarasi*, i cili më 1897 nxori numrin e parë të vjetarit *Ditërrëfënjësi (Kalendari) Shqip*, më vonë *Kalendari Kombiar*. Në Sofje, në fillim të shek. XIX dolën gazetat e para demokratike shqipe: *Drita* e Shahin Kolonjës (1901), *Vetëtima* e Thoma Abramit (1903), *Shqipëria* e Nikollë Lakos (1907) e të tjera më vonë. Këto organe problemën e *Reformave* në Maqedoni, në fillim të shek. XX e vështruan me kujdes dhe mbajtën qëndrim të drejtë ndaj problemit maqedonas. Ato e përcollën dhe i dhanë frymë Lëvizjes Demokratike Shqiptare duke i afirmuar programet dhe aksionet e Komitetit Qendror Shqiptar *Kombi* (1905) në krye me Albert Gjickën, mandej të *Komiteve të Fshehta për Lirinë e Shqipërisë* (1905) etj.

Nga vepra e I. Dërmakut shihet qart se në vitin 1908, pas Hyrrietit, numri më i madh i shoqërive shqiptare në Rumani do të bashkohet në Shoqërinë *Bashkimi* të Bukureshtit. Vetëm Nikollë Naço me *Dritën* e vetë do të ruajë „pavarësinë”. Shtypi i kolonive shqiptare në Rumani, Bullgari, e gjetkë, mori qëndrim të drejtë edhe ndaj Revolucionit Borgjez Xhonturk (1908) dhe bashkatdhetarëve u vuri në dijeni se sinqeriteti i borgjezisë turke është i barasvlerë me ato të borgjezive të tjera ballkanike e evropiane. Ato nuk e duan popullin shqiptar të lirë e të pavarur. Kolonitë shqiptare në Rumani e Bullgari në këtë kohë ishin shumë aktive në luftë për liri e pavarësi. Madje shtypi shqiptar në këto koloni në periudhën e kryengritjeve 1910—1912 paraqet, sot, buletin më besnik të Lëvizjes sonë për shkollë, për gjuhë, për kulturë

e për kishë shqiptare. Veçmas Shqybeja e Shqypënis (1909) e Josif Bagerit, me korespondentët nga të gjitha vendet e Kosovës dhe të Maqedonisë, regjistroi me besnikëri ecuritë e Lëvizjes për pavarësi. Problematikë të ngjashme trajtuan edhe *Liri e Shqipërisë* (1911) e *Lajmëtari* (1912) të Kristo Luarasit dhe gazeta e Konstancës *Atdheu (Patria)* më 1912 e L. M. Lehovës. Në gjiun e kolonisë shqiptare të Rumanisë u hartua dhe u ekzekutua për të parën herë *Himni kombëtar shqiptar*. Në atë mjedis Ismal Qemali dhe Luigj Gurakuqi morën vendim për Shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë, kurse gazeta *Liri e Shqipërisë* e para e publikoi vendimin e Kuvendit të Vlorës, më 28 nëntor 1912.

Vepra e I. Dërmakut, krahas anëve të mira ka edhe mungesa lëndore, e të meta të hetueshme në ndërtimin struktural, por edhe shumë gabime të natyrës tipografike. Por, që të jemi sa më objektiv, mungesat, të metat dhe gabimet që do të përmendim shkurtazi, duhet të mirren vetëm si gjykim ynë, i cili mund të jetë jo i drejtë. Qëllimi ynë është që lexuesit, studiuesit dhe autorit të veprës t'ua tërheqim vërejtjen, së fundi kujdesin, në disa anë të dobëta të veprës. Mirëpo, para se t'i përmendim disa nga të metat e veprës, vlen të konstatohet: Autori në fushë të hulumtimit dhe të vlerësimit kritik të burimeve është treguar këmbëngulës dhe energjik, kurse në fushën e përgatitjes teknike të veprës sikur del i dorëzuar. Këtu posaçërisht ndihet mungesa e punës njohëse të redaktorit shkencor, mungesa e punës së shkaktitë e korrektorit, por nuk kënaq as puna e lektorit dhe e redaktorit teknik.

Mbështetur në problematikën që trajtohet, titulli i veprës, sipas bindjes sonë, është shumë më i gjerë. Përmbytjes i përgjigjet një titull p. sh. si ky: *Kolonitë shqiptare të mërgimit në Rumani dhe Bullgari në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare*. Edhe ndërtimi i disa titujve të krerëve e të nënkrerëve sikur kërkon disa intervenime. Autori nuk

ka përdorë metodë të njëjtë të përqasjes në tërë veprën, sepse në një anë bëri, pak a shumë, tipizimin e problematikës kur është fjala për organizimin e shoqërive dhe të ndonjë problemi më shumë ad hoc, si ajo për I. Qemalin (fq. 64) etj., e në anën tjetër la pa tipizuar problematikën për çështje të ndryshme, të rëndësishme, si ato për Lëvizjen për gjuhë shqipe, për shkollë shqipe, për alfabet shqip, për kishë shqipe — shqiptare. Realisht, këto probleme I. Dërmaku nuk i la të pandriçuara, por për to foli të thuash vetëm gjatë përpunimit të burimeve, të regulloreve të shoqërive e të shtypit të Rilindjes. Së këndejmi pasqyrimi i problematikës sipas trajtimit që i kishte bërë periodiku i Rilindjes në vepër ka dalë pasqyrim panoramik, në njëfarë dore, një formë katalogizimi të burimeve që flasin për probleme të ndryshme të Rilindjes Shqiptare. Madje, do të kishte qenë i dobishëm një kapitull i ri për ngritjen dhe punën e shtypshkronjave shqipe të Kolonive, ku do të shihej edhe numri i përgjithshëm i veprave të botuara në Bullgari dhe Rumani deri më 1912. Mirëpo, këtu duhet të konstatohet se për këto probleme është folur në vepër, por në mënyrë shumë të shkapërderdhur dhe pa gjerësinë mundësisht të domosdoshme.

Në këtë vepër mund të vërehet edhe ndonjë moskonsekuencë në interpretim dhe në gjerësi të problemeve të shkruara. Shembulli vjen, ka raste kur problemi anësor është shpjeguar shumë më gjerësisht se sa e do vendi, bie fjala *Lidhja e Pejës* (1899, fq. 205), kurse në mënyrë shumë informative flet për Shoqërinë *Dëshira* të Sofjes (fq. 245). Madje duhet të konstatohet se Kolonia Shqiptare e Bullgarisë, krahas me atë të Rumanisë, është ndriçuar pak e sipërfaqësisht. Ndonjë vërejtje mund t'i bëhet edhe klasifikimit të materialeve. Ka raste kur materialet burimore të dorës së parë janë vënë në referensa, kurse

ato të dorës së dytë për vendin, janë vënë në tekst (fq. 235, 305, 321 etj.). Në tekst ka edhe ndonjë kontradiktë si rjedhim i të dhënave të traditës historiografike dhe të rezultateve të reja. Shembulli vjen, për Veqilharxhin kanë dalë dy data të vdekjes si të sigurta, 1854 dhe 1849 (fq. 28, 48). Doli se *Drita* e Brailës ishte në gjuhën shqipe (fq. 105), e ndonjë lapsus calemis tjetër.

Gabimet korrektuese janë të pranishme pos gjetkë, në referensa. Ka edhe përzjerje të rreshtave (fq. 54, 374, etj.). Edhe në citimin e autorëve, në referensa, shihen jokorrektësi, sepse dalin në fillim herë emri e herë mbiemri (fq. 50 etj.). Po ky lëshim i autorit është i pranishëm edhe në Treguesin e emrave (fq. 443 etj.). Ka raste kur as koha e daljes së ndonjë organi të mos jetë e saktë, e josaktësi në shënimin e emrave të organeve (fq. 430 etj.). Autori në tregues të fondeve arkivale, të lituraturës dhe të shtypit ka regjistruar shumë njësi që nuk janë përmendur në referensa, kurse veprës i mungon edhe lista e domosdoshme e gabimeve korrektuese. Studiuesi I. Dërmaku me kujdes sqaroi marrëdhëniet e Rilindjes Shqiptare me qarqet kulturore e politike në Rumani, Bullgari dhe Greqi, por të thuash nuk i preku fare marrëdhëniet politike e kulturele serbo-shqiptare. Përkatësisht nuk foli fare për qëndrimin e qarqeve politike e shkencore serbe borgjeze ndaj Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Interesimi i Mbretërisë serbe për vepërimtarinë e këtyre kolonive dhe për Rilindjen shqiptare nuk ishte më i vogël se interesimi i Greqisë, Bullgarisë dhe Rumanisë. Përkundrazi, ishte më intenziv, më i gjithanshëm dhe më armiqësor.

Kjo vepër e harrur nga të metat që i kemi hetuar, me rastin e një ribotimi, do të dalë edhe më e vlefshme për kulturën dhe dijen shqiptare.

MUHAMET PIRRAKU

Instituti Albanologjik  
Prishtinë